

VENDIM
Nr. 103, datë 3.4.2013

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO DURRËSI”
SUBJEKTIT: “RADIO DURRËSI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 2, datë 29.8.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.8.2005, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, të KKRT-së, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr. 91, datë 27.3.2013 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Radio Durrësi” sh.p.k., për radion vendore private “Radio Durrësi”, sipas licencës nr. 087/FML, në qarqet Fier-Vlorë.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati